



- karakteristikat kryesore të produktit dhe shërbimit;
 - çmimin, përbërjen, mënyrën e përdorimit dhe cilësinë e produkteve, periudhën minimale të garancisë, si dhe kushtet e shitjes;
 - ndikimin e produkteve të caktuara ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut, në përputhje me rregulloret dhe standardet, si dhe për masat mbrojtëse, nëpërmjet një udhëzimi të dhënë me produktin, të theksuar në paketimin e produktit ose në një mënyrë tjetër përkatëse;
 - të → drejtën e tërheqjes brenda 14 ditëve nga marrëveshjet e lidhura jashtë hapësirave afariste të tregtarit dhe marrëveshjet në distancë dhe
 - nevojën për servisim, pjesë rezerve, zëvendësim ose riparim të një produkti me defekt, respektivisht kthim të parave.
- informacione → të tjera relevante në lidhje me produktet dhe shërbimet.

E drejta për edukim

E drejta për edukim nënkupton që ne si konsumatorë duhet të edukohemi për të drejtat tona që në moshë të re. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton program njëvjeçar për mbrojtjen e konsumatorit që parashikon përgatitjen e broshurave, punëtorive, si dhe fushatave, me qëllim të rritjes së vetëdijes për të drejtat tona konsumatore. Në këtë drejtim, Ministria e Ekonomisë ofron mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për organizatat joqeveritare të konsumatorëve dhe mbështet sektorin joqeveritar në ofrimin e informacioneve dhe ndihmës për konsumatorët për funksionimin e byrove këshilluese për këshillimin e vazhdueshëm të konsumatorëve, organizimin e seminareve dhe përpilimin e broshurave për edukimin e konsumatorëve

Në fushën e procesit arsimor zbatohet Doracak për të drejtat e konsumatorëve për lëndën “Shkathtësitë e jetesës”. Ky doracak është përpiluar nga Organizata e Konsumatorëve të Maqedonisë dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Doracaku është dedikuar për mësimdhënësit që ligjërojnë lëndën ose realizojnë projekte të lira të nxënësve, respektivisht aktivitete me nxënësit, për të mbrojtur të drejtat e tyre si konsumatorë.

2. E drejta për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë

Kjo e drejtë nënkupton që produktet që i konsumojmë duhet të jenë të sigurta kur vendosen në treg, vihen në përdorim ose përdoren, veçanërisht me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së interesit publik, mbrojtjen e shëndetit tonë, të kafshëve dhe bimëve, si dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës.

E gjithë kjo arrihet duke miratuar rregullativë me të cilën standardizon kushtet për plasmanin e produkteve, paketimin, shpërndarjen e tyre, si dhe përdorimin e pesticideve dhe kimikateve të tjera që mund të ndikojnë në shëndetin tonë dhe mjedisin e përgjithshëm jetësor.



3. E drejta për mbrojtjen e interesave ekonomike

Kjo e drejtë përfshin:

- E drejta e qasjes në mallra dhe shërbime të shumëllojshme për të përmbushur nevojat tona themelore, me çmime të përballueshme dhe cilësi përkatëse;
- Mbrojtja nga dispozitat e padrejta kontraktuale që zvogëlojnë, vështirësojnë ose përjashtojnë të drejtat tona; • Mbrojtja nga praktikat mashtruese dhe agresive të tregut;
- Përgjegjësia e prodhuesit për produktet me mangësi dhe e drejta e servisimit të produkteve.



4. E drejta për dëmshpërblim

E drejta për dëmshpërblim është një nga të drejtat tona më të rëndësishme konsumatore, që nënkupton të drejtën për të kërkuar kompensim për dëmin që na është shkaktuar nga një produkt me defekt, e për të cilin prodhuesi është përgjegjës. “Me produkt nënkuptohet çdo mall ose lëndë, pavarësisht nga shkalla e përpunimit të tyre, të dedikuara që t' u ofrohen konsumatorëve ”

Produkti konsiderohet i dëmtuar nëse, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e në veçanti mënyrën në të cilën produkti na është prezantuar, qëllimet në të cilat, sipas pritshmërisë së arsyeshme, produkti mund të përdoret dhe kohën kur produkti është vënë në qarkullim, nuk ofron siguri për atë që pritet në mënyrë të arsyeshme nga këto produkte. Nëse na është shkaktuar dëm nga një produkt me defekt, duhet të dëshmojmë dëmin, defektin dhe lidhjen shkakore-pësore midis



defektit dhe dëmit. Gjithashtu, nëse na është shkaktuar dëm, së pari duhet të kontaktojmë tregtarin për të kompensuar dëmin me marrëveshje, e në të kundërtën mund të kërkojmë kompensim për dëmin në procedurë gjyqësore.



5. E drejta e përfaqësimit

E drejta përfaqësimit (e drejta për të qenë i dëgjuar) Kjo nënkupton që të gjithë ne si konsumatorë kemi të drejtë të organizohemi në organizata konsumatore në nivel lokal, kombëtar dhe të Bashkimit Evropian, të cilat do të mbrojnë interesat tona, organizata në të cilat mund të theksojmë ankesat tona, propozimet tona për përmirësimin e të drejtave tona, ku mund të marrim këshilla, si dhe përfaqësimin tonë në organet shtetërore ku diskutohen të drejtat dhe interesat e konsumatorëve.



Konsumatorët kanë të drejtat e tyre dhe nuk duhet të heshten!